

29.08.2023
Ora 11:35

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Ylli Merkaaj
- Parti Politike: S’ka prezent
- OJQ: S’ka prezent

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 11:30. Në kuadër të zgjedhjeve për kryetarin e Bashkisë Kukës në datën 24 shtator, Komisioni Rregullator, ka zhvilluar dhe po zhvillon disa mbledhje për miratimin e akteve të nevojshme për zhvillimin e këtyre zgjedhjeve. Në rendin e ditës së sotme kemi dy projektakte:

I pari, “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023” dhe,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.08.2023*

I dyti, “Për miratimin e orarit të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

Të dy projektaktet kanë ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Para se të fillojmë me shqyrtimin e akteve që kemi në rendin e ditës, do të pyesja anëtarët e Komisionit Rregullator, të gjithë të pranishëm në mbledhje, nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Kolegë?! Jo! Fillojmë me rendin e ditës. Zoti Merkaj, ju lutem një prezantim të shkurtër të projektaktit “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit”.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Neni 20, pika 1, shkronja “g”, dhe pika 3 e Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për furnizimin dhe administrimin e materialit zgjedhor. Gjithashtu neni 98, pika 1 i Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e KQZ-së për përgatitjen e fletëve të votimit. Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, është hartuar projektvendimin “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”. Me vendimin nr. 2/2023 Komisioni Rregullator ka miratuar disa karakteristika teknike të fletëve të votimit që do të përdoren për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Gjithashtu me vendimin nr. 9, datë 1.3.2023, janë ndryshuar kodet e fletës së votimit si vijon: Kodi i ngjyrës së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie është PANTONE 7401 U (ngjyrë e artë).

Kemi propozuar të miratohen edhe disa karakteristika të tjera teknike të fletës së votimit si vijon:

Lloji i letrës të jetë: Letër me thurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet;

Dimensionet e fletës së votimit propozohen të jenë formati A-4:

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.08.2023*

Gjerësia e fletës së votimit jo më e vogël se 210 mm;

Gjatësia e fletës së votimit jo më e vogël se 297 mm;

Orientimi i fletës së votimit, propozohet të jetë: Portret;

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra.

Logo KQZ, me ngjyra.

Kemi propozuar edhe barkodet :

- Numri serial 7 shifra
- Qarku 2 shifra
- Bashkia 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra.

- Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit do të jenë:


- Zona Zgjedhore;
- Qendra e votimit.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Ashtu sikurse dhe ju theksuat pak më herët, kompetenca e KQZ-së në këtë rast ndahet mes Rregullatorit që miraton specifikimet teknike të fletës së votimit dhe Komisionerit që miraton përmbajtjen e fletës së votimit pas paraqitjes së kandidaturave. Me sa kemi parë dhe vlerësuar është e njejta fletë votimi, të njejtat specifikime teknike si ato që janë përdorur në zgjedhjet e 14 majit. Ndërkohë në zgjedhjet e 14 majit ne kemi miratuar karakteristikat teknike për dy fletë votimi. Një për kryetarin dhe një për këshillin, ndërkohë që këtu kemi vetëm një lidhje që është “karakteristikat teknike të fletës për kandidatët për kryetarë bashkie”. Kolegë, ju lutem kemi diçka lidhur me projektvendimin në parim?

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.08.2023*

Z. M. Çakaj: Më fal zonja Kryetare! U njoha me materialet, por nuk e pashë bashkëlidhur një model të fletës së votimit. Pavarësisht se Sekretari i Përgjithshëm relatoi që është e njejta fletë votimi siç u përdor në zgjedhjet e datës 14 maj.

Z. Y. Merkaç: Do të jetë e njejta fletë votimi që është përdorur për kandidatët për kryetarë të zgjedhjeve të 14 majit. E njejta, në ngjyrë të artë, PANTONE 7401 U.

Z. M. Çakaj: Pra, me të njejtat kode?

Z. Y. Merkaç: Po!

Z. M. Çakaj: Dakord, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Kolegë, kemi diçka tjetër në parim në lidhje me projektaktin?! Kalojmë në votimin në parim të tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në shqyrtimin pikë për pikë të tij.

Atëherë, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

1. Miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Karakteristikat teknike, ka nevojë t'i lexoj? Janë ato që përmendi Sekretari i Përgjithshëm.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.08.2023*

Lloji i letrës:

Letër me thurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit jo më e vogël se 210 mm

Gjatësia e fletës së votimit jo më e vogël se 297 mm

Që i bie formati A-4?

Z. Y. Merkaj: Po! Formatu A-4.

Znj. I. Nano: Pra, jo më e vogël se A-4.

Orientimi i fletës së votimit: Portret

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra.

Logo KQZ, me ngjyra.

Ngjyra e fletës së votimit është pikërisht ajo që diskutuam, ngjyrë e artë që është përdorur dhe në zgjedhjet e 14 majit, PANTONE 7401 U

Barkodi

- Numri serial 7 shifra
- Qarku 2 shifra
- Bashkia 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra dhe elementin ndarës “/” ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit.

Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit

Zona Zgjedhore

Qendra e votimit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.08.2023*

Atëherë kolegë për pikën 1, kemi diçka? Kalojmë në votimin e pikës 1!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 2. Në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen brenda afatit ligjor, mund të ndryshohen përmasat e fletëve të votimit.

Është pak a shumë e njëjta situatë që kemi vlerësuar dhe në 14 maj. Pra, nëse do të jenë shumë subjekte zgjedhore që marrin pjesë do të ndryshojë fleta, në kuptim të ndryshimit të përmasave. Kolegë, për pikën 2? Nuk ka diçka! Kalojmë në votimin e pikës 2!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.08.2023*

Kalojmë me votimin në tërësi të projektvendimit, edhe njëherë kolegë vullnetin tuaj! Po, zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Ngarkohet administrata dhe nëse ka organe të tjera.

Znj. I. Nano: Po! Zoti Merkaj, shiheni gjatë zbardhjes. Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, edhe njëherë kolegë vullnetin tuaj?!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Vendim nr. 31

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



29.08.2023
Ora 11:43

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e orarit të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|--------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Ylli Merkaj |
| Parti | Politike: | S’ka prezent |
| OJQ: | | S’ka prezent |

Znj. I. Nano: Projektvendimi i dytë është: “Për miratimin e orarit të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

Është një tipologji vendimi që ne jo gjithmonë e marrim pasi vetë Kodi Zgjedhor parashikon oraret e votimit për zgjedhjet kur ato caktohen në periudhat përkatëse zgjedhore. Pra, kur periudha zgjedhore është nga 15 prilli në 15 maj, qendrat e votimit hapen në orën 7:00 dhe mbyllen në orën 19:00. Kur caktohen në periudhën zgjedhore nga 15 tetori deri në 15 nëntor ndryshon orari i mbylljes, pra hapja është në orën 7:00, por mbyllja është në orën 18:00. Sa herë që kemi

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.08.2023*

zgjedhje jashtë.., përtej këtyre dy periudhave zgjedhore, Rregullatori përcakton me vendim dhe orarin e votimit. Zoti Merkaj, diçka lidhur me këtë akt!

Z. Y. Merkaj: Nuk kemi ndonjë gjë veç atyre që thatë ju. Kur jemi jashtë periudhës zgjedhore, pra dy periudhat që ka përcaktuar Kodi Zgjedhor 15 prill deri më 15 maj dhe 15 tetor deri në 15 nëntor, kemi parashikuar që është më e përshtatshme të jetë ora 7:00 e mëngjesit me orën 19:00. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Kolegë, ju lutem kemi diçka lidhur me këtë projektvendim? Jo!

Kalojmë në votimin në parim të tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në shqyrtimin pikë për pikë të tij.

Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

1. Qendrat e votimit, ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, hapen në ora 07:00 dhe mbyllen në ora 19:00.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)


Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.08.2023*

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë me votimin në tërësi të projektvendimit, edhe njëherë kolegë!

Znj. H. Vukaj: Para se të kalojmë, diçka për kujtesë, zonja Kryetare. Në relacionin e këtij projektakti, keni përdorur në fund që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet administratës, i propozon Komisionit Rregullator. Nuk ka ura ndërmjetësimi në propozim, kështu që Komisioneri i propozon drejtpërdrejt Komisionit Rregullator. Së dyti, kam vënë re që relacionet sa po vijnë dhe po tkurren. Unë personalisht, por besoj dhe kolegët, do të preferonim relacione shtjelluese, argumentuese dhe arsyetuese. Faleminderit!

Z. Y. Merkaçaj: Vërejtja është me vend, do ta rregullojmë, faleminderit!

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit!

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.29.08.2023*

Sapo miratuam orarin e votimit për zgjedhjet e pjeshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023.

Meqenëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës për të shqyrtuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendim nr. 32

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

